



Dt. 12.03 2025 Në përputhje me statutin e Komunës së Pejës, ligjin për qeverisje lokale me numër 03L/040, dhe rregulloren e Komunës së Pejës me nr.02/2016 për “Tituj të Nderit, Dekorata, Medalje, Mirënjohje dhe Falenderime”, respektivisht me nenin 6, pika 6 e kësaj rregulloreje, DKRS lëshon këtë:

### **THIRRJE PUBLIKE**

për propozime të kandidatëve për “Tituj Nderi”

Ftohen të gjitha institucionet Publike dhe Private, Organizatat Joqeveritare, Grupet Joformale qytetare (me seli dhe adresë) dhe mediat që të kontribuojnë në zgjedhjen e personave meritore për titujt të nderit si:

- 1.Titulli “Qytetar Nderi”
- 2.Titulli “Qytetar Nderi i Huaj”
- 3.Titulli “Qytetar Nderi Post Mortum”
- 4.Titulli “Nderi i Qytetit”
- 5.Titulli “Lekë Dukagjini”
- 6.Titulli “Haxhi Zeka”
- 7.Titulli “Azem Shkreli”

Gjithashtu, ftoheni që ti sillni propozimet edhe për persona (kandidatë) të cilëve do t’iu ndahen dekoratat si:

- 1. **Mirënjohje, Falenderime**- për kontributin e tyre ndër vite si dhe
- 2. **Laureat për të drejtat e grave dhe vajzave**- për kontributin e dhënë në mirëqenien dhe profilin e grave dhe vajzave meritore.

### **PROPOZIMET DUHET TË PËRMBAJNË:**

- 1.**Biografinë** e kandidatit të propozuar
- 2.**Arsyetimin** – të sqarohet cili ka qenë kontributi i kandidatit që ai/ajo të meriton titullin e propozuar (2000 fjalë)
- 3.**Fakte** të cilat vërtetojnë arsyetimin ( fotografi, shkrime, publikime)
- 4.**Listën e nënshkrimeve (minimalisht 200)** të personave që e kanë dhënë propozimin (lista të përmbaj: emrin .mbiemrin, ditëlindjen, vendlindjen, numrin personal, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e secilit propozues)

### **SI TË APLIKONI:**

**Të përpiqet shkresa Zyrtare/ PROPOZIMI** të cilit duhet t’i bashkangjitet letërnjoftimi i personit përfaqësues / Aplikuesit.

**Lënda duhet të dorëzohet** e mbështjellur në bustë (zarfë) të mbyllur në sportelin e administratës

**Afati i dorëzimit** të propozimeve është me datë: 12.03.2025 deri më 14.04.2025

**Lënda duhet t’i drejtohet: Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport**

Për t’u informuar rreth përkufizimeve të titujve, ju lutem hyni në faqen elektronike të Komunës së Pejës, në rubrikën Rregulloret dhe shkarkoni rregulloren për Dekorata.

Ky është linku:

<https://kk-arkiva.rks-gov.net/peje/getattachment/35a59117-5a89-4e59-8df4-250d2c47bd5c/Rregullore-Nr-02-2016-per-tituj-tenderit-dekoratav.aspx>